



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 118, datë 10.12.2009**

**MBI**

**REFUZIMIN E RINOVIMIT TË LICENCËS SË AGJENTIT NË SIGURIME**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” dhe kreut VI, pika 1, gërma c të VKM nr 79, datë 28.01.2008 “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe të rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës”, me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoritetit i Mbikëqyrjes Financiare,

**K O N S T A T O I S E:**

Agjentja në sigurime, në emër dhe për llogari të shoqërisë “Insig” sh.a, Zj. Lumturi Cjapi, me licencë nr 6, dt. 19.09.2006, ka paraqitur në Autoritet kërkesën së bashku me dokumentacionin përkatës për rinovim të licencës.

Gjatë periudhës të ushtrimit të veprimtarisë së ndërmjetësimit në Autoritet është depozituar një ankesë, sipas të cilës agentja lejonte një person tjetër (bashkëshortin e saj) të nënshkruante kontrata në emër të saj dhe të një shoqërie tjetër. Nga dy inspektime të kryera nga Autoriteti rezultoi se agentja Cjapi kishte hapur një pikë tjetër shitje ku së bashku me bashkëshortin Z. Zyhdi Hoxha, kishin punësuar persona të pa licencuar, të cilët shisnin polica të shoqërisë “Insig” dhe “Sigma”. Agjentja Cjapi nuk i vuri në dispozicion, grupit të inspektimit asnjë dokumentacion me pretendimin se sistemi nuk punonte prej një muaji.

Po ashtu gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 583 AKT datë 16.07.2008, ka deklaruar Z. Zyhdi Hoxha, fajtor për kryerjen e veprës penale “Fallsifikim të Dokumentave”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal. Gjatë gjykimit është provuar se z. Hoxha, bashkëshort i agjentes Cjapi, priste polica sigurimi në zyrën e agjentes Cjapi duke i fallsifikuar ato.

Autoriteti i kërkoi informacion shoqërisë “Insig” sh.a, shoqëria me shkresën nr 686/1 prot, datë 10.03.2009, pasi analizoi situatën, pranoi se veprimet e agjentes në fjalë përbëjnë, “*veprime të pa rregullta në fushën e ndërmjetësimit dhe njëkohësisht shkelje të detyrimit kontraktor*”.

Me veprimet e mësipërme agentja Lumturi Cjapi ka shkelur ligjin pasi sipas nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, ”... nuk ka të drejtë të autorizojë asnjë person tjetër që të nënshkruajë kontratën e sigurimit në emër dhe për llogari të tij...”.

Për sa më sipër Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Refuzimin e rinovimit të licencës për një periudhë 6 mujore Zj. Lumturi Cjapi, si pasojë e shkeljes së nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004
2. Ngarkohen Departamentet përkatës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Elisabeta GJONI**